



ASOCIACIONI I KOMUNAVE TË KOSOVËS

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE E RAPORTIT TË PROGRESIT PËR VITIN 2016

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Gjatë vitit 2016, Asociacioni i Komunave të Kosovës ka punuar në funksion të përfaqësimit dhe mbrojtjes së interesave të komunave, ofrimit të shërbimeve të avancuara dhe përmirësimit të performancës së komunave, konsolidimit dhe fuqizimit të strukturave të reja të AKK-së dhe performancës së mirë financiare. Këto aktivitete janë të bazuara në Planin Strategjik të AKK-së për vitin 2016-2020, Planin Vjetor 2016 si dhe në agjendën legislative dhe prioritetet e përcaktuara vjetore nga strukturat udhëheqëse.

Duke ditur se linjat kryesore të planit strategjik të AKK-së janë: (1) Avokimi dhe lobimi proaktiv, (2) Ngritja efektive e kapaciteteve, (3) Ofrimi i shërbimeve të përmirësuara dhe (4) Efikasiteti organizativ, AKK-ja ka ndjekur këto pika edhe me Planin Vjetor 2016.

Sa i përket pikës së parë të Planit Strategjik, AKK-ja përmes aktiviteteve të saja vjetore të paraqitura në Planin Vjetor të Punës për vitin 2016 ka arritur t'i përmbush deri në **68 %** të objektivit. Gjatë këtij viti, në këtë fushë, AKK ka qenë e sfiduar nga institucionet qendrore (Qeveria dhe Parlamenti) të cilat duke mos iu përmbajtur agjendës së tyre legislative, për disa ligje të cilat nuk janë proceduar për amendamentim, sikur Ligji për Vetëqeverisjen Lokale, AKK nuk ka pasur mundësi të dërgoj komentet dhe rekomandimet e veta ashtu siç ishte planifikuar. Gjithashtu vërehet se ka mos koordinim ndërministror dhe mes organizatave partnere ndërkombëtare në harmonizimin e qëndrimeve për çështje që prekin nivelin lokal (detajet janë në faqen 7).

Rreth ngritjes efektive të kapaciteteve, si objektiv i dytë, AKK-ja ka ndërmarrë një varg aktivitete bazuar në Strategjinë, Planin Vjetor por edhe në studimin e DEMOS/SDC, ku përfshihen trajnime, vizita studimore, punëtori etj. Në këtë drejtim ky objektiv, i cili këtë vit ka prekur realizimin e plotë, është arritur mbi bazën e punës me Kryetarët e Komunave, Kolegjiumeve, anëtarët e Kuvendeve të Komunave dhe zyrtarë tjerë lokal. Pavarësisht këtyre rezultateve, është vërejtur se sfida në këtë drejtim është qasja e ndryshme e institucioneve vendore dhe ndërkombëtare të cilat ofrojnë trajnime pavarësisht nevojave të komunave dhe pa koordinim e vlerësim nevojash me vetë përfituesit direkt të atyre trajnimeve.

Tek objektiv i tretë, AKK-ja ka ofruar shërbime të avancuar të cilat kanë pasur ndikim direkt në performancën e komunave përmes formave të ndryshme. Kjo është realizuar përmes analizave, hulumtimeve, asistencës teknike dhe studimeve tjera që kanë të bëjnë me ofrimin e shërbimeve më cilësore për qytetarët e tyre. Si indikator matës në realizimin e kësaj objekte janë hulumtimet nga organizatat lokale e ndërkombëtare të cilat masin perceptimin dhe kënaqshmërinë e qytetarëve ndaj komunave, të cilat hulumtime rendisin nivelin lokal me lartë se nivelin qendror. Sfidë e AKK-së në këtë drejtim ka qenë disbalanci mes kërkesave të komunave dhe mundësive buxhetore të AKK-së për plotësimin e tyre dhe në disa raste mos gatishmëria e Qeverisë Qendrore për t'iu përgjigjur nevojave të komunave.

AKK-ja gjatë vitit 2016 ka përmbushur në plotni objektivin për efikasitetin organizativ sipas planifikimeve vjetore. Në këtë drejtim strukturat politike të AKK-së, duke u zhveshur tërësisht nga petku politik i tyre, kanë mbështetur e përfaqësuar kërkesat e komunave,

pavarësisht përkatësisë etnike, politike e gjinore të tyre. Ky unitet i strukturave tona ka sjellë këto rezultate pozitive të cilat janë implementuar suksesshëm edhe nga pjesa ekzekutive e AKK-së.

Poashtu në aspektin e mbledhjes së anëtarësisë, AKK-ja në vitin 2016 jo vetëm që ka vazhduar me trendin pozitiv por ka arritur që të tejkaloj të gjithë pritshmërinë në realizimin e këtij objekti. Kështu objekti i paraparë në buxhetin tonë për vitin 2016 ishte 135,000€, AKK ka realizuar dhe tejkaluar këtë synim duke mbledhur 180,449 €.

Kërkesat në rritje të komunave ndaj AKK rreth ofrimit të shërbimeve dhe laramanisë së tyre, të pambuluara deri më tani është një sfidë e re, sidomos për vitet në vijim. Këto kërkesa po vijnë edhe si rezultat i përfaqësimit dhe mbështetjes së fuqizuar të AKK-së ndaj nivelit lokal, e ku komunat kanë potencuar besueshmërinë e tyre të lartë ndaj AKK-së si i vetmi mekanizëm që i mbron, lobon dhe i mbështet kërkesat e tyre në të gjitha nivelet dhe forumet. Në këtë kontekst sfidë mbetet mbingarkesa e stafit ekzekutiv të AKK-së për plotësimin e kërkesave të shtuara të komunave vit pas viti. Po ashtu një çështje sfiduese është edhe buxheti, sepse AKK-ja me të hyra vetanake mund të mbulojë kryesisht shpenzimet operative ndërsa për zhvillimin e aktiviteteve kërkohet ende përkrahje buxhetore nga partnerët.

Në anën tjetër, pika strategjike që ka sfiduar më së shumti AKK-në në implementimin e saj është ndërtimi efektiv i kapaciteteve në nivelin lokal, kryesisht për arsye të mos koordinimit dhe sidomos kur shumica e organizatave që merren me nivelin lokal duan të të merren patjetër edhe me ndërtimin e kapaciteteve, ku rezultatet efektive shpesh jo vetëm që mungojnë por edhe krijojnë një situatë ku i humbet kuptimi këtij aktiviteti në pikëpamje të vetë përfituesve.

Sa i përket Planit të Punës 2016, gjatë këtij viti AKK ka realizuar mbi 90 % të tij. Ky plan është rishqyrtuar pas 6 mujorit të parë ku është vërejtur që në disa raste ka pasur veprime legislative të pa parapara me Agjendën Legislative të Qeverisë dhe Parlamentit dhe sidomos më çështjet që kanë të bëjnë me aktet nënligjore, prandaj janë shtuar angazhimet dhe veprimet tona në përballje me këto ndryshime. Në anën tjetër, me iniciativën e AKK-së në vitin 2016 janë hartuar Koncept Dokumentet për Projekt Ligjin për Dhënien e Pronës Komunale në Shfrytëzim dhe Projekt Ligjin për Trajtimin e Ndërtimeve Pa leje dhe gjatë vitit 2017 pritet finalizimi i tyre.

Tek Objektiva e parë e Planit të Punës, Lobimi dhe Avokimi, përkundër angazhimeve të AKK-së jo të gjitha rekomandimet tona janë marrë parasysh. Kjo ka ndodh meqë në disa raste niveli qendror po zhvillon politikën e saja dhe zhvillimet po i shikon nga këndi nacional e jo vetëm nga këndi lokal.

Po ashtu gjatë vitit 2016 ka pasur disa devijime nga Plani i Punës me amendamente të ligjeve të caktuara meqë disa ministri të linjës nuk i kanë paraparë në agjendën legislative për vitin 2016 dhe për këtë arsye edhe AKK-ja nuk ka patur aktivitete dhe veprime siç është Ligji mbi vetëqeverisje lokale.

Në këtë periudhë lobimi, AKK-ja ka qenë e përqendruar në: (1) Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës (në vazhdimësi po nevojitet të llobohet lidhur me këtë projekt ligj); (2) Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje; (3) Projektligji për inspektime; (4) Projektligji për financat lokale; dhe (5) Projektligji për tatimin në pronë. Përfaqësuesit e Asociacionit të Komunave morën pjesë në Këshillin Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik atë për Integrim dhe Komisionin Kombëtar Kundër Korrupsionit, ku i prezantuan qëndrimet e komunave të Kosovës. Rezultati i arritur deri më tani është që 68 % e rekomandimeve dhe sugjerimeve të AKK-së janë inkorporuar në projektligjet finale të miratuara nga Parlamenti i Kosovës. Ky rezultat mund të konsiderohet si i kënaqshëm për AKK.

Bordi dhe Kolegjiumet e AKK-së kanë hartuar planet vjetore të punës me prioritete, angazhime dhe synime, duke u bazuar në agjendën legislative të Qeverisë Qendrore. Në këtë periudhë raportimi janë mbajtur nga 6 takime mesatarisht për secilin Kolegjium (disa kolegjiume edhe më shumë takime), 32 takime të kryesive të Kolegjiumeve duke zhvilluar dhe konsoliduar nga së paku dy qëndrime për secilin Kolegjium. Përveç kësaj, AKK-ja ka marrë pjesë në takime të Komisioneve të ndryshme me qëllim të dhënies e vërejtjeve dhe sugjerimeve si dhe shqyrtimin e projektligjeve gjatë shqyrtimit të legjislacionit.

Gjatë periudhës raportuese, në formën tjetër vlen të cekën edhe këto të arritura:

- Projekt Ligji për Inspektime nuk është pranuar nga AKK-ja (dhe për momentin ky draft është tërhequr nga diskutimi për shkak të pozicionit të AKK-së), ku njëra ndër vërejtjet kryesore e cila u evidentua ishte edhe ajo e paralajmërimit paraprak të inspektimit të subjekteve ekonomike nëpër nivele të ndryshme qeverisëse. Pa rekomandimet e AKK-së, nuk do të mund të zbatohet në praktikë, ngase ishte në kundërshtim me disa ligje tjera të cilat janë në fuqi, po ashtu do të pengonte punën e zyrtarëve të inspeksionit, me procedura shumë burokratike dhe të shumëfishuara.
- Tek Projekt Ligji i Trajtimit të Ndretimeve pa Leje, angazhimi i AKK-së ka avokuar për:
 - 1) kërkesat e komunave për ndarjen dhe uljen e taksës për legalizim të jetë 1.00 €
 - 2) për rastet sociale legalizimi të bëhet falas dhe si pjesë e lehtësirave për qytetarët procesi i legalizimit të kryhet nga komuna dhe jo nga kompanitë private
 - 3) për shkak të kostos së lartë, me synimin që komuna të shkon tek qytetari për të kryer legalizimin.
- Përmes plotësim ndryshim të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit (AKP), AKK-ja ka arritur që të inkorporohet kërkesa e komunave për kthimin e pronës së paluajtshme në pronësi të komunës nga AKP, ndalja e procesit të likuidimit në rastet kur prona është komunale pas marrjes së vendimit nga Kuvendi i Komunës.
- AKK-ja tek Katalogu i vendeve të punës u angazhua dhe dha rekomandime konkrete që grupi punues duhet të plotësonte Katalogun edhe me pozitë që i ka niveli lokal e që në fillim nuk ishin të përfshira. Mos angazhimi i AKK-së me Kolegjiumet Profesionale do të anashkalonte shumë pozitë të punës dhe koeficientë të pagës të shërbyesve civil nga niveli lokal dhe komunat do të ishin të pa konsultuara dhe të mos përfshira në proces dhe kërkesat e tyre do mbeteshin të pa trajtuara.
- Pas rekomandimeve të AKK-së për Projektligjin për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, atyre do të ju lehtësohen procedurat, do ju mundëson me shumë marrëdhënie kontraktuale me biznese të cilat do të ndikonin në zhvillimin ekonomik komunal, në punësim e të rinjve dhe në performancën e komunës në përgjithësi.

AKK-ja konsideron që me këto ndryshime komunat do t'a kenë me lehtë në të ardhmen për të bërë më atraktiv ambientin për investime të huaja dhe vendore.

Në funksion të përmbushjes së obligimeve statutores është mbajtur Kuvendi i Përgjithshëm Vjetor si dhe takimet e Këshillit të Kryetarëve dhe takimet e rregullta të Bordit të AKK-së. Segment tjetër është edhe miratimi i Planit të ri Strategjik të AKK-së 2016-2020. Bordi ka mbajtur 10 takime formale dhe disa jo-formale. Këshilli i Kryetarëve të AKK-së është takuar në gjashtë takime të rregullta. Duhet të kemi parasysh se përveç numrave të takimeve që i përmendëm më lartë, Bordi dhe Këshilli i AKK-së kanë pasur edhe disa takime tjera me ministrinë e linjës dhe Kryeministrin e Kosovës e që këto takime kanë qenë të bashkë-organizuara me AKK-në .

AKK-ja ka vazhduar të mbaj kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunat. Në këtë periudhë tek komunat janë dërguar mbi 85 shkresa të ndryshme, njoftime, raporte, kthim përgjigje, projekt-ligje, projekt-rregulloret, rekomandime, propozim qëndrime, etj. Uebfaqja e AKK-së vazhdon të mirëmbahet në baza ditore, Këtë vit është dizajnuar edhe zhvilluar edhe uebfaqja e re e AKK-së me pamje dhe përmbajtje të re. Në 'Facebook' postohen vazhdimisht të gjitha lajmet dhe aktivitetet e saja dhe publikimi dymujor i Buletinit. Këtu vlen të cekim aktivitetet "Java e Komunave" ku në bashkëpunim dhe mbështetje edhe nga MAPL, DEMOS dhe GIZ, AKK-ja ka shënuar 15 vjetorin e themelimit dhe ka forcuar imazhin e vetë si përfaqësuese e interesave të Komunave.

Në aspektin financiar, gjatë vitit 2016 nga anëtarësia janë mbledhur € 180,449 ku është tejkaluar objektivi i përcaktuar prej € 135,000. Pesë prej gjashtë komunave të Kosovës me shumicë serbe kanë paguar pagesën e anëtarësisë (Graçanica, Ranillugu, Parteshi, Novobërda dhe Klllokoti kanë paguar, ndërsa Shtërpca nuk ka paguar).

Bashkëpunimi me partnerë, AKK-së i ka ndihmuar në lobim e avokim, në realizimin e shumë projekteve që kanë përfituar komunat qoftë në fonde, përkrahje financiare në projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime punëtori, shkëmbim të përvojave etj. SDC-ja si partneri kryesor në zhvillimin dhe avancimin e AKK-së ka dhënë kontribut thelbësor si mbështetje për AKK-në. Bashkëpunime me projekte të ngjashme janë implementuar me DEMOS, GIZ, NALAS, ACT/USAID-in, UNDP, UNICEF, Save the Children, Projekte të përkrahura nga Komisioni Evropian, OSBE-në etj. Po ashtu janë organizuar takimet "Miqte e AKK-së" më partnerët kryesor të komunave të Kosovës të cilët merren dhe punojnë në fushën e qeverisjes lokale. AKK-ja ka vazhduar t'i përfaqësoj qëndrimet dhe interesat e komunave dhe të kontribuoj tek koordinimi i donatorëve me pjesëmarrjet e rregullta në takimet e Komitetit Drejtues të projekteve të rëndësishme të donatoreve në fushën e Qeverisjes Lokale dhe Shërbimeve Komunale, siç janë SDC/DEMOS, SDC/RWSSP, GIZ/SMS, etj.

2. OBJEKTIVAT STRATEGJIKE TË AKK-së PËR VITIN 2016

Strukturat e Asociacionit të Komunave të Kosovës edhe në vitin 2016 kanë ndjekur objektivat të bazuara në Strategjinë e re 2016/2020 dhe Planin Vjetor të AKK-së. Ndër objektivat kryesore për vitin 2016 janë: Përfaqësimi dhe mbrojtja e interesave të komunave përmes

Lobimit dhe Avokimit, ofrimi i shërbimeve më të avancuara dhe përmirësimi i performancës së Komunave, funksionaliteti i strukturave të AKK-së, qëndrueshmëria financiare, bashkëpunimi me partnerët në pikëreferim të AKK-së, komunikime me komunat dhe performanca e administratës së AKK-së.

3. ZHVILLIMI E KONSOLIDIMI I POLITIKAVE (QËNDRIMEVE)

Në vazhdim të procesit të deritanishëm, Asociacioni i Komunave të Kosovës synoi dhe arriti që përmes strukturave të saj sikurse janë: Bordi, Këshilli i Kryetarëve, Kolegjiomet dhe Komisionet të konsolidojë qëndrimet e veta karshi institucioneve qendrore me synim zhvillimin e politikave të cilat do të ndihmonin në fuqizimin e rolit të vazhdueshëm të komunave.

Në këtë vit, lobimi i AKK-së ka qenë i përqendruar në disa çështje me prioritet për komunat sikurse janë: Projekt-Ligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të komunës, Projektligji për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Projektligji për inspektime, Projektligji për financat lokale dhe Projektligji për tatimin në pronë.

Në të njëjtën kohë konsolidimi i qëndrimeve dhe politikave u bë edhe për çështjet siç ishte rregullimin e pagesës së anëtarëve të Kuvendit të Komunës - përmes mëditjeve jo pagave (për këtë qëndrim janë pyetur të gjithë anëtarët e Kuvendeve komunale në Kosovë, komunave anëtare të AKK-së), shtyrja e afatit për ri-shikim të buxhetit deri më 3 qershor nga ana e MF-së (po mos të ndodhte kjo shtyrje, komunat mund të humbnin mjete financiare të cilat do të reflektonin shumë në mos-implementimin e projekteve kapitale në interes të qytetarit), ngase afati ishte i shkurtër dhe komunave iu duhej ende kohë për ri-shqyrtim të buxhetit si dhe pjesëmarrja e përfaqësuesve të Asociacionit të Komunave në Këshillin Kombëtar për Zhvillimin Ekonomik dhe prezantimi i qëndrimeve të komunave të Kosovës.

AKK-ja rregullisht ka takuar Bordin dhe Kolegjiomet për planet vjetore të punës, prioritetet e angazhimeve dhe synimeve bazuar edhe në agjendën legislative të Qeverisë Qendrore. Në kuadër të planeve vjetore të Kolegjiomeve ka vazhduar të trajtohet me seriozitet edhe vazhdimi i punës në implementimin e Strategjive të Kolegjiomeve. Segment tjetër është edhe Strategjia e re e AKK-së 2016/2020.

4. LOBIMI DHE AVOKIMI

4.1 Lobimi

AKK-ja edhe këtë vit ka qenë e angazhuar në lobim si shtylla kryesore dhe më me ndikim tek autoritetet komunale. Në raste të caktuara, lobimi i AKK-së shpesh zgjat me periudha më të gjata dhe pas konsolidimit të qëndrimeve edhe me organizata e donatorë që merren me qeverisjen lokale në Kosovë. Por këtu po sfidohej edhe në një aspekt tjetër si ndryshimi i qasjes së donatorëve rreth çështjeve të ndryshme e që ndikojnë drejtpërdrejtë në proceset lobuese të AKK-se. Ka raste kur deri këtë vit një donator shumë i rëndësishëm ka qenë pro

decentralizimit të një shërbimi në nivelin komunal, e tani për hirë të projekteve dhe qëndrueshmërisë së tyre organizative ata dalin kundër qëndrimeve dhe parimeve të deritanishme dhe përkrahin qeverinë qendrore në aktivitetet të cilat nuk janë pro decentralizimit të një shërbimi. Kjo e vë AKK-në pozitë shumë të vështirë me donatorin. Megjithatë, shpresohet që të shpejtë donatorët të kuptojnë dhe të pranojnë se misioni kryesor i AKK-së është të vihen në pah/të dëgjohen pikëpamjet nga interesat komunale.

Po ashtu AKK-ja, vazhdimisht po sfidohet sa i përket lobimit edhe nga aspekte tjera. Përveç që shumë organizata që punojnë në projekte të ndryshme rreth qeverisjes lokale dhe aktivitetet e tyre ndërlidhen me lobimin, ata nganjëherë i dyfishojnë aktivitetet duke punuar dokumente, ofruar trajnime, punëtori të ngjashme me ato të AKK-së. Rreth lobimit ishte një tendencë për ndërhyrje edhe nga ministria që merret me administrimin e komunave. MAPL-ja ka pasur qëllim të krijojë një mekanizëm të ngjashëm me mekanizmat profesional të AKK-së - Kolegjiomet, për të shqyrtuar të gjitha aktet ligjore dhe nënligjore në fazën e diskutimeve publike, pastaj të dal me rekomandime, se ato janë nga MAPL-ja. MAPL ka kërkuar përkrahje financiare nga DEMOS rreth kësaj iniciative dhe pasi që AKK ka pranuar një draft dokument për diskutim nga MAPL rreth kësaj çështje, AKK ka pasur konsultime me DEMOS-in dhe SDC-në, dhe pas këyre konsultimeve DEMOS nuk e ka përkrahur një iniciativë të tillë financiarisht. Neve mendojmë që kemi arritur të ndalojmë këtë iniciativë të MAPL-së duke mos lejuar që punën tonë disa vjeçare ta kopjojë dhe të na pengojë në aktivitetet tona në të ardhmen, pasi që lobimi është një ndër fokuset tona kryesore në realizimin e objektivave të AKK-së. Pra, AKK përveç punëve dhe angazhimeve të ditëpërditshme bazuar në planin vjetor, duhet patjetër të jetë edhe si watch-dog për të gjitha organizatat dhe institucionet që të venerojë që mos dikush po tenton ta luaj rolin e njëjtë si të AKK-së.

Po ashtu gjatë këtij viti, sfidë është paraqitur edhe çështja menaxhimit të burimeve njerëzore, ku Menaxherët Komunal të Personelit kanë paraqitur kërkesë për themelimin e Kolegjiomet të Menaxherëve të Personelit. Kërkesa është rishqyrtuar dhe miratuar në muajin prill 2016 ku edhe është themeluar Kolegjiomi i Menaxherëve të Personelit. Kështu numri i përgjithshëm i Kolegjiomeve Profesionale të AKK-së ka arritur në 13. Vlen të ceket se ata kanë qenë të organizuar mirë dhe nëse menaxhmenti i AKK-së do të ishte indiferent ndaj kërkesës së tyre ata paralelisht do të themelonin një lloj forumi të personelit dhe do të kryenin aktivitetet e tyre veçmas si strukturë, pa koordinim me AKK-në. Fusha e Personelit ndërlidhen me të gjitha procedurat e punësimit nëpër komuna, me performancën e shërbyesve civil, me ngritjen e kapaciteteve, gradimet, avancimet etj. Kështu që ky Kolegjiom tani do të ndihmojë që shërbimi civil në komuna, të koordinojë politikën rekrutuese, të koordinojë aktivitete rreth ngritjes së kapaciteteve, të koordinojë politikën rreth projektligjeve që lidhen me fushën e shërbimit civil, rreth pagave dhe rreth ligjeve tjera që kanë të bëjnë me punën e shërbyesve civil në fushën profesionale, certifikimin e disa kategorive të shërbyesve civil etj. Për këtë arsye, ky pritjet të jetë një Kolegjiom shumë i rëndësishëm.

Si përfundim, në pjesën e lobimit, për fat të keq, përveç angazhimeve ditore rreth lobimit, përfaqësimit, mbrojtjes së interesave të komunave, ngritjes së kapaciteteve, shkëmbimit të përvojave në mes komunave, organizimit të konferencave, punëtorive, etj. AKK është duke u sfiduar dhe po nevojitet të harxhojë energji dhe kohë edhe më çështje të cilat janë të lartë përmendur e që sipas mendimit tonë nuk i bëjnë nder zhvillimit të mëtutjeshëm demokracisë

lokale në Kosovë dhe forcimit të organizatave lokale të cilat punojnë për dhe në emër të autoriteteve lokalë në Kosovë.

4.2 Projekt Ligji për Inspektive

Konteksti

Projekt Ligji për Inspektive i draftuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI), është një ndër ligjet kyçe për komunat. Me aprovimin e këtij ligji komunave do të i'u lehtësohej vendosja e rendit sidomos në aktivitetet afariste të ndërmarra në komunë. Me qëllim të bashkërendimit të qëndrimeve të komunave në raport me këtë Projekt Ligj janë organizuar disa takime në mes të Kolegjiut të Inspeksionit, menaxhmentit të AKK-së me zyrtarë të MTI-së.

Të arriturat

Koncepti i MTI-së për të rregulluar fushën e inspeksionit në komunë, u konsiderua se nuk është i pranuar nga niveli lokal duke paraqitur argumente konkrete me shembuj në praktikë. Njëra ndër vërejtjet kryesore e cila u evidentua ishte edhe ajo e paralajmërimit paraprak të inspektimit të subjekteve ekonomike, marrja e pëlqimit paraprak të personit përgjegjës me qëllim realizimin e inspektimit apo edhe kërkesa për autorizim nga ana e gjykatës kompetente për të hyrë në lokale pa pëlqimin e personit përgjegjës. Si i tillë, ky ligj, sipas Drejtorëve Komunal për Inspeksion, nuk do të mund të zbatohet dhe të jetë funksional, ashtu siç ka ndodhur dhe është duke ndodhur me zbatimin e ligjit mbi inspektoratin e tregut. Andaj duke i rishikuar këto vërejtje, projekt-ligji është ndaluar dhe tërhequr nga diskutimet e mëtejshme me grupet e interesit. Pas rekomandimeve të AKK-së, ky dokument është rikthyer tek Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për Ri-diskutim.

Impakti

Aprovimi i këtij projekt Ligji duke i marrë parasysh qëndrimet e AKK-së të arritura me konsensus nga komunat, do të lehtësonte funksionimin e komunave në fushën e inspektimit, fushë kjo e cila është ndër më të rëndësishmet e pushtetit lokal, përmes së cilës ndikohet drejtpërdrejtë në cilësinë e jetesës së qytetarëve. Në të kundërtën, projektligji pa rekomandimet e AKK-së, nuk do të mund të zbatohet në praktikë, ngase ishte në kundërshtim me disa ligje tjera të cilat janë në fuqi, po ashtu do të pengonte punën e zyrtarëve të inspeksionit, me procedura shumë burokratike dhe të shumëfishuara.

Konkluzë

Po të aprovohej ky ligj si i tillë, do të mund të sillte deri te situata shumë konfliktuoze në mes qytetarëve dhe institucioneve lokale në Kosovë. Kjo është edhe sfidë e AKK-së se duhet bindur organizatat ndërkombëtare se para se të fillojnë hartimin e ligjeve duhet marrë parasysh edhe rrethanat politike, ekonomike dhe qytetare në Kosovë sepse ligjet të cilat po hartohen në këtë mënyrë nuk po mund edhe të implementohen në terren.

4.3 Ligji i Trajttimeve e Ndërtimeve Pa Leje (ligji i ri)

Konteksti

Që prej aprovimit të Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje në dhjetor - 2013, procesi i legalizimit është ballafaquar me sfida të vazhdueshme në teren. Përkundër sugjerimeve të vazhdueshme nga ana e AKK-së, se ky proces duhet të ketë disa ndryshime substanciale që të ketë sukses në zbatimin e tij, por të cilat nuk u morën parasysh nga ana e Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor deri në momentin e ballafaqimit me dështimin total të tij. Me insistimin e AKK-së dhe pas shumë takimeve me Ministrin, MMPH-ja më në fund e mori iniciativën të ri-draftoj projektligjin për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje. Duhet theksuar se në Kosovë janë evidentuar mbi 350.000 ndërtime pa leje kurse për shkak të ligjit të deritanishëm për legalizim në tërë komunat e Kosovës nuk kanë aplikuar as 5% e tyre. Ky fakt ka shtyrë komunat e Kosovës që përmes AKK-së të fillojnë lobimin në nivel qendror për fillimin e ndryshimit të këtij ligji. Njëherësh dëshirojmë të theksojmë se Ministri i MMPH-së ka qenë shumë konstruktiv sa i përket rekomandimeve të AKK-së për fillimin e procesit të ndryshimit të këtij ligji.

Të arriturat

Angazhimi i AKK-së është përqendruar në kërkesat e komunave për ndarjen dhe uljen e taksës për legalizim sepse kjo taksë ka shtyrë qytetarët që të mos aplikojnë për legalizim e objekteve pa leje. Kolegjiumi i Planifikimit Hapësinor në kuadër të AKK-së ka rekomanduar që taksa për legalizim të jetë 1.00 €, kurse për rastet sociale legalizimi të bëhet falas (kjo vlen për objektet pa leje deri në 450 m²). Ky propozim është përkrahur edhe nga Këshilli i Kryetarëve. Po ashtu si pjesë e lehtësirave për qytetarët procesi i legalizimit të kryhet nga komuna dhe jo nga kompanitë private për shkak të kostos së lartë, me moton dhe synimin që komuna të shkojë tek qytetari që ta përfundojë procesin e legalizimit. Me këtë ndryshim, për qytetarët, procesi i legalizimit do të jetë më i thjeshtë dhe jo si ka qenë më parë. Deri më tani, qytetarët kanë qenë të detyruar ose e kanë pas të nevojshme të kontraktojnë një kompani private, në mënyrë që t'i mbledhin dhe t'i rregullojnë dokumentet për të aplikuar për legalizim. Gjithashtu është kërkuar që pas përfundimit të procesit të legalizimit prona të bartet në mënyrë automatike edhe në dokumentacionin kadastral si proces përfundimtar i legalizimit në pronën e qytetarit.

Impakti

Përmes ndryshimeve të reja në projektligjin për Trajtimin e Ndërtimeve Pa Leje, komunat do të kenë mundësinë që me sukses të përfundojnë trajtimin e ndërtimeve pa leje ekzistuese duke vendosur siç duhet rregull në fushën e ndërtimit, dhe që të ketë një prerje të periudhës së ndërtimeve pa leje në mënyrë që procesi i legalizimit të përfundojë një herë e përgjithmonë në të ardhmen nëpër komunat por edhe në anën tjetër t'ia bëjnë më të lehtë qytetarit legalizimin e objekteve të ndërtuara pa leje përkatëse.

4.4 Ligji për Agjencinë Kosovare të Privatizimit

Konteksti

Ministria e Financave ka filluar me procesin e plotësim ndryshimit të Ligjit për Agjencinë Kosovare të Privatizimit. Ky institucion dhe veprimtaria e tij kanë qenë temë debati disa herë përveç e Kolegjiumeve përkatëse edhe e Këshillit të Kryetarëve të AKK-së. Duke pasur parasysh rëndësinë që kanë veprimet e AKP-së për komunat me iniciativë të AKK-së janë organizuar një varg takimesh në mes të strukturave të AKK-së dhe të udhëheqjes së AKP-së, me qëllim të paraqitjes së pozitës së komunave në raport me pronën e paluajtshme të ndërmarrjeve shoqërore nën administrim të AKP-së e të cilat janë në komunat e Kosovës.

Të arriturat

Kërkesat e AKK-së drejtuar MF-së për të përfshirë qëndrimet e AKK-së në procesin e plotësim ndryshimit të Ligjit për AKP-në si kërkesa për kthimin e pronës së paluajtshme në pronësi të komunës nga AKP, ndalja e procesit të likuidimit në rastet kur prona është komunale pas marrjes së vendimit nga Kuvendet Komunale përkatëse do të ishte një e arritur e rëndësishme duke marrë parasysh kërkesat e vazhdueshme të komunave ndër vite për të trajtuar këtë çështje.

Impakti

Me qëllim të përmbushjes së nevojave institucionale lokale, pronat e paluajtshme aktualisht të administruara nga AKP-ja, në rast të kalimit në pronë komunale, do të mundësonte që ato toka të shfrytëzohen për destinim tjetër e që do të jetë me ndikim në interesin publik. Gjithashtu ndalimi i procesit të likuidimit dhe dhënia e këtyre pronave komunave do të ishte një mundësi shtesë për komunat në aspektin e rregullimit dhe avancimit të proceseve të zhvillimit ekonomik lokal.

4.5 Katalogu i vendeve të punës

Konteksti

Katalogu i vendeve të punës, që prej vitit të kaluar është në proces të realizimit dhe ende nuk është finalizuar. Procesi rreth harmonizimit të qëndrimeve mes nivelit qendror dhe lokal ka qenë mjaft sfidues. Shërbimi Civil në Kosovë është unik, po ashtu funksionon në bazë të meritës, andaj qëllimi i AKK-së ka qenë që pozitën e njëjta të trajtohen njëjtë si në nivelin qendror ashtu edhe në nivelin lokal. Ky proces i rregullimit të kategorizimit të vendeve të punës është një pjesë e reformës së administratës që po synohet të arrihet në Kosovë dhe njëkohësisht këtij procesit pritet të ndihmojë edhe miratimi i Ligjit të Pagave, sepse ende nuk është kompletuar sistemi ashtu siç duhet secila pozitë e punës të rregullohet me kosto financiare dhe me mjete shtesë për ngritje të kapaciteteve të shërbyesit civil.

Të arriturat

AKK-ja së pari ka ndihmuar për hartimin e model-dokumentit për kategorizimin e vendeve të punës në nivelin lokal. Disa herë janë organizuar takime me Kolegjiumet Profesionale, me Kryetar të Komunave, me Ministrinë e Administratës Publike, njëkohësisht edhe me zyrtarët e

MAP-it, me qëllim të përfshirjes së të gjitha pozitave që janë funksionale në komuna dhe harmonizimi i koeficientëve mes pozitave të njëjta. Në një masë shumë të madhe (rreth 93%) kërkesat tona janë marrë parasysh dhe ende po punohet që deri në finalizim të dokumentit zyrtarët e komunave të jenë të konsultuar në të gjitha fazat e procesit në mënyrë që të jenë të përfshira të gjitha pozitat e punës dhe rregullimi i koeficientëve të pagave ashtu siç duhet në katalogun e vendeve të punës. Implementimi i Katalogut të Punës është dashur të fillojë së zbatuari nga muaji gusht 2016, por ende nuk janë dakorduar dy ministritë e linjes, ajo e Financave (MF) dhe e Administratës Publike (MAP), pasi që sipas MF, duhet Ligji i Pagave të miratohet që t'i prijë zbatimit të Katalogut të Vendeve të Punës.

Impakti

Shumë pozita në **nivelin lokal nuk ishin paraparë në katalogun e vendeve të punës**, ngase në grupin punues nuk kishte asnjë anëtar nga niveli lokal, për të paraqitur pozitat e shërbyesve civil të komunave. AKK-ja mori këtë rol dhe vazhdimisht lloboi, u angazhua dhe dha rekomandime konkrete që grupi punues duhet të plotësonte Katalogun e vendeve të punës edhe me pozitat që i ka niveli lokal e që në fillim nuk ishin të përfshira. Po ashtu me vonë përsëri u sfidua niveli lokal duke mos i harmonizuar disa pozita të njëjta me koeficientë të njëjtë, mes nivelit qendror dhe nivelit lokal. Mos angazhimi i AKK-së me Kolegjiunet Profesionale do të anashkalonte shumë pozita të punës dhe koeficientë të pagës të shërbyesve civil nga niveli lokal dhe komunat do të ishin të pa konsultuara dhe të mos përfshira në proces dhe kërkesat e tyre do mbeteshin të pa trajtuara.

4.6 Projektligji për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës

Konteksti

Pas dy vite e gjysmë punë lobuese nga ana e AKK-së, përmes formave të ndryshme dhe kërkesave të vazhdueshme ndaj Qeverisë se ky ligj duhet të hyj në procedurat e hartimit. Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka hartuar koncept-dokumentin. Ky ligj edhe pse ka qenë në fuqi nuk ka gjetur zbatim për arsye se ligjit i ka munguar hapësira për dhënien e mundësisë së zhvillimit ekonomik lokal.

Të arriturat

E arritura më e madhe është që ky ligj do të ndryshojë (pas një kohe të gjatë pune dhe angazhimi të AKK-së). Po ashtu AKK-ja ka paraqitur rekomandimet konkrete që duhet të merren parasysh dhe që janë edhe qëllimi kryesor pse duhej ndryshuar ligji.

Çështjet kyçe që duhet të trajtohen në fushën e Dhënies në Shfrytëzim dhe Këmbim të Pronës së Paluajtshme të Komunës janë: - Procedurat e përzgjedhjes së investitorit privat, - Procedurat për negociim të marrëveshjeve dhe rrethanat kur mund të negociohen ato pa procedura konkurruese, - Ndërtimi i një sistemi elektronik të regjistrimit të pronave të paluajtshme komunale dhe përcaktimi i destinimit të tyre, - Dhënia në shfrytëzim të pronës së paluajtshme për qëllim të ndërtimit të hapësirave banuese kolektive më qëllim social.

Duhet të theksohet që AKK ka disa vite që është duke lobuar në mënyrë që ky ligj të fillojë të ndryshohet dhe së fundi ka arritur që përmes zërit të saj ta shtyjë Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të fillojë amandamentimin e këtij ligji. AKK duhet të lloboj te MAPL (si

sponsorizues i këtij ligji) që ajo të fillojë me amandamentimin e këtij ligji në vend që kjo të ndodhë pa asnjë lobim duke e konsideruar që MAPL-ja thirret se kinse i mbron interesat e komunave në Këshillin e Ministrave. Ligji pritet të fillojë të hartohet në vitin 2017 dhe po ashtu të fillojë së zbatuari po në këtë vit.

Impakti

Komunat janë ballafaquar me shumë probleme sa i përket dhënies së pronës komunale në shfrytëzim dhe këmbimin e saj. Ky ligj prek në mënyrë të drejtpërdrejtë interesat e komunave, në mënyrë të veçantë interesat që kanë të bëjnë me zhvillimin ekonomik lokal. Ndryshimi i këtij ligji duke marrë parasysh rekomandimet e AKK-së, komunave do të ju lehtësonte procedurat, do të ju mundësonte me shumë marrëdhënie kontraktuale me biznese të cilat do të ndikonin në zhvillimin e komunës, në punësim e të rinjve dhe në performancën e komunës në përgjithësi. AKK-ja konsideron që me këto ndryshime komunat do t'a kenë me lehtë në të ardhmen për të bërë më atraktiv ambientin për investime të huaja dhe vendore.

Pra, është në proces të diskutimit publik Koncept dokumenti për këtë ligj. Koncepti ka paraparë tri alternativa, 1) mbetja e ligjit të njëjtë në fuqi ; 2) ndryshim-plotësim i ligjit dhe 3) hartimi i ligjit të ri. AKK-ja ka shqyrtuar këtë Koncept Dokument me kolegjiunet profesionale dhe ka dalë me qëndrimin se përkrah opsionin e tretë, hartimin e ligjit të ri, i cili kishte me i dhënë shumë mundësi komunave për zhvillimin ekonomik të tyre. Pritet shumë shpejt ky Koncept Dokument të miratohet në Qeveri, dhe pas miratimit fillon procesi i hartimit të ligjit, ku AKK-ja do të jetë anëtar në grupin punues dhe do të jap kontributin e vet profesional.

4.7 Ligji për Kadastër

Konteksti

Meqenëse ne konsiderojmë se ky ligj centralizon një kompetencë që e kanë komunat, Kadastrin, po ashtu centralizon edhe një pjesë e stafit dhe ajo që ka më së shumti rëndësi, të hyrat financiare që inkason komuna nga shërbimet që iu ofron qytetarëve, do të barten në Agjensionin për Kadastër, atëherë ne u tërhoqem si anëtar të grupit punues dhe njëkohësisht paraqitem vërejtjet tona, që jemi kundër dhe nuk pajtohemi që Kadastrin të rregullohet në vijën vertikale dhe aq më tepër të barten edhe financat si dhe stafi.

Të arriturat

Fal lobimit tonë të vazhdueshëm me përfaqësuesit e Ministrisë së Financave kemi arritur që ministria në fjalë, të ndalojë centralizimin e financave nga fusha e Kadastrit nga Komunat në Agjensionin Kadastral të Kosovës. MF-ja ka refuzuar propozimin e Agjencionit të Kadastrit që vet të menaxhojë me financat pasi që nuk ka mekanizëm që kontrollon këto të hyra, kështu që financat duhet të mbesin në nivelin lokal .

Impakti

Komunat një ndër drejtoritë e tyre e kanë edhe Drejtorinë e Kadastrit, andaj aty menaxhohet kadastrin, ka një staf dhe sigurisht që krijohet edhe financa nga shërbimet që u ofrohen qytetarëve. Nëse do të i'u centralizohej kjo kompetencë, komunat do të kishin humbur edhe një pjesë të stafit dhe do të i'u kishin zvogëluar të hyrat financiare.

4.8 Ligji për Prokurimin Publik

Konteksti

Pas ndryshimeve të bëra në Ligjin Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik në janar të vitit 2016, AKK ka organizuar punëtori me shumicën e kolegjiemeve dhe me të gjithë zyrtarët e prokurimit në komuna. Nga këto punëtori ka dalë që ligji i lartë cekur (i plotësuar dhe ndryshuar) obligon që zyrtarët e prokurimit të trajnohen dhe certifikohen në përputhje me rregulloret, udhëzimet dhe vendimet përkatëse të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP) pasi që certifikatat ekzistuese janë valide deri me 31 dhjetor 2016.

Në bazë të Ligjit për Prokurimin Publik, më 31 dhjetor 2016 përfundon vlefshmëria e certifikatave për prokurim publik për të gjithë zyrtarët e prokurimit. Që të sigurohet vazhdimësia e prokurimit publik në nivel komunal dhe në pajtueshmëri me Ligjin për Prokurim Publik, KRPP dhe Instituti i Kosovës për Administratë Publike, me mbështetjen e Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe programit të USAID-it “Avancojmë Kosovën së Bashku”, organizuan trajnime për certifikim të zyrtarëve komunal për prokurimin publik.

Të arriturat

Pas organizimit dhe ftesës së bërë nga ana e AKK-së, Kryetarët e 38 komunave kanë dërguar në KRPP aplikacionet zyrtare për trajnimin dhe certifikimin e nga dy zyrtarëve komunal për prokurimin publik deri në fund të vitit 2016. Trajnimi profesional dhe certifikimi i zyrtarëve për prokurimin publik në nivelin komunal është mbajtur në kohëzgjatje prej 15 ditësh në sallën e Qendrës së Studentëve në Prishtinë në periudhën prej 6 shtatorit e deri më 25 nëntor. Komunat me qëllim të lehtësimit të procesit të ndjekjes së trajnimit janë ndarë në dy grupe. Në bazë të nenit 25 të Ligjit për Prokurimin Publik, zyrtarët komunal pas trajnimit do t'i nënshtrohen testit dhe në bazë të rezultateve edhe do të marrin certifikatë për kryerjen e aktiviteteve të prokurimit publik për tri vitet e ardhshme.

Impakti

Me ndryshimin e ligjit të prokurimit dhe të kërkesës obligative për certifikim të zyrtarëve të prokurimit në komuna, përmes këtij trajnimi është mundësuar vazhdimësia e proceseve të prokurimit në komuna pa ndonjë stagnim.

Përveç përfitimit të njohurive të reja rreth ndryshimeve në prokurim, zyrtarët komunal të prokurimit kanë pasur mundësi gjithashtu të trajnohen edhe në modulet e e-prokurimit si një risi në Kosovë dhe kjo është në harmoni me objektivat e AKK-së për të avancuar e-qeverisjen në komuna.

5. PUNA E KOLEGJIUMEVE PËR SHËRBIME NDAJ KOMUNAVE

Kolegjiimet kanë vazhduar angazhimin në diskutimin e çështjeve me rëndësi në fushat përkatëse përmes shqyrtimit të ligjeve dhe akteve tjera nënligjore me qëllim ndikimin gjatë proceseve vendimmarrëse në fuqizimin dhe mbrojtjen e kompetencave komunale.

Kolegjiimet e AKK-së në vijim kanë përcaktuar prioritetet dhe aktivitetet e punës për këtë vit, si dhe kanë shqyrtuar programin legjislativ për vitin 2016 në identifikimin e temave të

ndryshme, duke qenë pjesë e grupeve punuese të cilat do të jenë me interes në zhvillimin e aktiviteteve të Kolegjiumit në të ardhmen.

Secili Kolegjium ka përgatitur dhe miratuar planin e punës për vitin 2016, në përcaktimin e objektivave dhe aktiviteteve sipas agjendës vjetore të tyre. Deri më tani janë mbajtur nga 6 takime mesatarisht nga secili Kolegjium (varësisht nga nevoja edhe më shumë), po ashtu janë mbajtur 32 takime të kryesive të Kolegjiumeve. Gjatë punës dhe angazhimit të tyre, Kolegjiumet kanë zhvilluar dhe konsoliduar qëndrimet në aktivitetet e tyre të punës, ku janë mbajtur takime me partnerë dhe bashkëpunëtorë me qëllim dhënien e vërejtjeve dhe sugjerimeve në shqyrtim të projektligjeve gjatë shqyrtimit të legjislacionit.

Disa prej rezultateve të cilat kanë arritur Kolegjiumet përmes angazhimit me punën e tyre në dhënien e rekomandimeve ku kanë arritur ndryshimin dhe përmirësimin e shërbimeve ndaj komunave janë:

Kolegjiumi i Menaxherëve të Personelit: marrë parasysh rëndësinë e kolegjiemeve profesionale në lobimin dhe diskutimin e çështjeve me interes për komunat, Asociacioni i Komunave të Kosovës është ballafaquar me kërkesën e vazhdueshme të udhëheqësve të personelit në komuna për krijimin e një Kolegjiumi të ri në kuadër të AKK-së. Duke u përballur me nismën e organizuar të menaxherëve të personelit për krijimin e Kolegjiumit të ri si një strukturë paralele me financa të garantuara jashtë përbërjes së Asociacionit, Bordi i AKK-së konsideroi si të arsyeshëm miratimin e kërkesës së tyre në themelimin e Kolegjiumit të Menaxherëve të Personelit pasi që fusha e personelit ndërlihet me të gjitha procedurat e punësimit në komuna, me performancën e shërbyesve civil, ngritjen e kapaciteteve, gradimet dhe avancimet. Për këtë qëllim Kolegjiumi i Menaxherëve të Personelit do të ndihmojë në koordinimin e politikave rekrutuese, aktiviteteve në ngritjen e kapaciteteve dhe lobimin në projektligjet në fushën e shërbimit civil.

Kolegjiumi për Shërbime Publike: me synimin përmirësimin e shërbimeve publike në komuna, kolegjiiumi është në vazhdim të punës në hartimin e udhëzuesve për hartimin e planeve të mobilitetit dhe planeve për mirëmbajtje dhe investime në hapësirat e hapura publike, në bashkëpunim të ngushtë me DEMOS, për të përmirësuar dhe harmonizuar nevojat për një lëvizje të lirë dhe të sigurt për të gjithë pjesëmarrësit në trafik, si dhe menaxhimin e mirëmbajtjes së hapësirave publike në mënyrë më cilësore në rigjallërimin e hapësirave ekzistuese dhe krijimin e hapësirave publike të reja, që të siguroj cilësi më të mirë të jetesës për qytetarët e saj.

Kolegjiumi i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunave: me qëllim përmbushjen e njërit prej rekomandimeve kryesore të Auditorit të Përgjithshëm, brenda kornizës së raporteve të auditorit komunal, Kolegjiumi i Kryesuesve është angazhuar në bashkëpunim me Kolegjiumet tjera në hartimin e një draft rregulloreje “model” për subvencionet, e cila do të përdoret për zëvendësimin e rregulloreve ekzistuese e që mund të jenë jo të përshtatshme duke u bazuar në Rregullën Financiare nr. 01/2013/MF mbi shpenzimin e parasë publike, gjegjësisht i cili parasheh që çdo pagesë e subvencionit apo transferit duhet të ketë bazë të qartë juridike, ku komunat duhet të hartojnë dhe miratojnë rregullore specifike komunale për ndarjen e subvencioneve. Kjo pritet të rrisë transparencën e vendimmarrjes dhe në këtë mënyrë të zvogëlojë hapësirën për praktikimin e korrupsionit.

Kolegjiumi për Inspeksion: përkundër vërejtjeve të mëhershme kundrejt centralizimit të kompetencave në fushën e inspektorëve të tregut të iniciuara nga niveli qendror, kolegjiu për inspeksion u konsultua mbi Projektligjin e ri për Inspektime nga Ministrisë Tregtisë dhe Industrisë. Drafti u konsiderua si pengesë e mëtutjeshme nga ana e institucioneve qendrore në rregullimin e procesit dhe zbatimin e punës së përditshme të inspeksion komunal. Njëra ndër vërejtjet kryesore e cila u nënvizua ishte ajo e paralajmërimit paraprak të inspektimit të subjekteve ekonomike, marrja e pëlqimit paraprak të personit përgjegjës me qëllim realizimin e inspektimit apo edhe kërkesa për autorizim nga ana e gjykatës kompetente për të hyrë në lokale pa pëlqimin e personit përgjegjës, duke marrë parasysh se një projektligj i tillë do të ishte i pazbatueshëm në teren dhe do të paraqiste një pengesë të madhe për punën inspektuese të komunave. Gjatë muajit qershor, Ministria përkatëse ishte akoma duke e shqyrtuar qëndrimin, vërejtjet dhe rekomandimet e AKK-së. AKK-ja do të ndjekë procesin dhe do llojoj edhe më tej deri në miratimin përfundimtar të ligjit.

Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor: zbatimi i procesit të trajtimit të ndërtimeve pa leje në praktikë tregoi procesin e vështirë të legalizimit, sikurse është kostoja numri i lartë ndërtimeve ilegale. Edhe pse në mënyrë të vazhdueshme Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor ka shprehur nevojën për ndryshimin e ligjit për trajtimin e ndërtimeve pa leje, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor ka ndërmarrë nismën në përpilimin e një drafti të ri të projektligjit për ndërtimet pa leje. Pjesa më e madhe e propozimeve nga Kolegjiumi për Planifikim Hapësinor të inkorporuar në projektligjin e ri, janë si produkt i bashkëpunimit dhe angazhimit të përbashkët në mes Asociacionit të Komunave të Kosovës dhe Ministrisë së Planifikimit Hapësinor në diskutimin e shqetësimeve të ngritura nga përfaqësuesit komunal në bazë të evidentimit të pengesave në teren, thjeshtimin e procedurave për legalizim, uljen e kostos dhe regjistrimin përfundimtar të pronës në dokumentet kadastrale dhe plotësimin e akteve tjera nënligjore që me sukses të përfundojë trajtimi me ndërtime pa leje duke vendosur rregull në fushën e ndërtimit.

Kolegjiumi për Buxhet dhe Financa: Njëra ndër sfidat kryesore të kolegjiut mbetet çështja e shkurtimeve buxhetore në kategoritë e ndryshme, andaj si pikë përqendrimi parësor në fushën e financave lokale mbetet rishikimi i buxhetit komunal 2016, ku përmes bashkëpunimit dhe debatit me Ministrinë e Financave është arritur rezultati se nuk do të ketë ndërhyrje në buxhetin total të komunës, po ashtu nuk do të preket buxheti lidhur projektet kapitale dhe kategorinë paga dhe mëditje sikurse lejohen lëvizjet në mes të kategorive mallra dhe shërbime, shpenzime komunale dhe subvencione e transfere. Në këtë drejtim Kolegjiumi po lobon po ashtu në gjetjen e mekanizmave në përcaktimin e kriterëve në planifikimin dhe realizimin e të hyrave vetanake komuale.

Kolegjiumi për Zhvillim Ekonomik: në bashkëpunim me Swisscontact u inicua diskutimi dhe gjetja e alternativave në ofrimin e mbështetjes në fushën e turizmit si një sektor i rëndësishëm për zhvillimin ekonomik lokal. Diskutimi u përqendrua në mundësitë e zhvillimit të këtij sektori në të ardhmen nëpër komuna, trendet dhe zhvillimet aktuale në sektorin e turizmit përmes mbështetjes në ofrimin e punësimit drejt një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik. Si shembull i mirë në shkëmbimin e praktikave të mira u prezantua projekti i Komunës së Pejës në mbështetjen dhe zhvillimin e këtij sektori.

6. QËNDRUESHMËRIA FINANCIARE E AKK-së

6.1. Konteksti i shkurtër

Falë angazhimit të strukturave të AKK-së (administratës dhe nivelit politik), si dhe përkrahjes së partnerëve ndërkombëtarë, me theks të veçantë SDC-së, AKK ka arritur që të hyjë në një fazë të re e cila reflekton një qëndrueshmëri të konsiderueshme financiare.

Asociacioni i Komunave të Kosovës ka si synim të vazhdueshëm ndërtimin e një sistemi të qëndrueshmërisë financiare që garanton ruajtjen e pavarësisë funksionale dhe statusore të saj. Edhe pse AKK që nga themelimi e deri sot është përballur më vështirësi dhe sfida të shumta të cilat kanë reflektuar direkt në qëndrueshmërinë financiare të saj. Megjithëkëtë, AKK ka arritur që të krijoj jo vetëm një trend pozitiv në krijimin e qëndrueshmërisë financiare, por edhe në ndryshimin e perceptimit të komunave ndaj AKK-së duke rezultuar më ndërtimin e raporteve kontraktuale dhe mirëbesuese të dyanshme.

Kjo është dëshmuar edhe në Kuvendin e Përgjithshëm të AKK-së që u mbajt në muajin Mars 2016 përmes pjesëmarrjes masive të komunave dhe anëtarësisë së komunave më shumicë serbe dhe minoriteteve tjera. Poashtu vlerësimi i punës së AKK-së dhe kënaqshmëria e Komunave anëtare të saj është duke u matur në mënyrë të pavarur nga sondazhet e porositura nga ana e organizatës gjermane GIZ. Të dhënat nga këto sondazhe janë shumë inkurajuese duke treguar një kënaqshmëri gjithnjë e më të madhe të komunave dhe akterëve të tjerë me punën e AKK-së. Ky mirëbesim ka vazhduar edhe në vitin 2016.

6.2. Të arriturat gjatë vitit 2016

Asociacioni i Komunave të Kosovës jo vetëm që ka vazhduar me trendin pozitiv në realizimin e njërit nga objektivat kryesore që ka të bëjë me qëndrueshmërinë financiare të saj, por ka arritur që gjatë vitit 2016 të tejkaloj të gjithë pritshmërinë në realizimin e këtij objekti. Objektivi i paraparë në buxhetin e AKK për vitin 2016 është 135,000€. Brenda periudhës referuese AKK ka realizuar dhe tejkaluar objektivin e paraparë, duke mbledhur 180,449 €. Pesë prej gjashtë komunave të Kosovës me shumicë serbe kanë paguar pagesën e anëtarësisë (Graçanica, Ranillugu, Parteshi, Novobërda dhe Kllokoti kanë paguar, ndërsa Shtërpca nuk ka paguar).

Si suksese të arritura në kuadër të këtij objekti mund të konsiderohet edhe vazhdimi i aktiviteteve lobuese që kanë për qëllim nxitjen e Komunave në kryerjen e obligimeve financiare ndaj AKK-së. Ky lobim është bërë përmes mekanizmave të AKK-së, si Kolegji i ekspertëve profesionalë e në veçanti përmes Këshillit të Kryetarëve si një mekanizëm që mbledh të gjithë kryetarët e Komunave.

AKK vazhdon bashkëpunimin e shkëlqyeshëm me projektin DEMOS për të ndikuar tek komunitatet të cilat përfitojnë nga grantet e këtij projekti lidhur me kryerjen e pagesës së anëtarësisë ndaj AKK-së. Bashkëpunimi i AKK-së me partnerët e ndryshëm në këtë drejtim do të ketë një impakt shumë pozitiv në qëndrueshmërinë financiare të AKK-së. Vlen të theksohet se AKK, ka zgjeruar projektet e saj në dobi të Komunave edhe me organizatën Gjermane GIZ, projekte këto që kanë pasur efekt edhe në sensibilizimin e Komunave në kryerjen e obligimeve ndaj AKK-së.

Brenda periudhës referuese, Bordi i AKK-së, përkatësisht Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv kanë vazhduar vizitat e rregullta në Komunat përmes të cilave kanë dëgjuar shqetësimet e

Komunave për problemet më të cilat ballafaqohen ato. Kryetari dhe Drejtori Ekzekutiv i AKK-së kanë shprehur gatishmërinë e AKK-së për të adresuar të gjitha brengat e Komunave në instancat përkatëse. Këto vizita kanë shërbyer si një mundësi e mirë për të sqaruar edhe pozicionin financiar të AKK-së si dhe nevojën për një qëndrueshmëri financiare të vazhdueshme.

6.3. Financimi nga palët e treta

Financimi nga palët e treta nënkupton grantet e realizuara nga AKK përveç atyre të realizuara nga programi i financuar nga SDC. Në këtë drejtim AKK për vitin 2016 ka paraparë një buxhet në total prej €77,000 nga organizata të ndryshme financuese, si NALAS, COUNCIL OF EUROPE, GIZ. Në periudhën referuese, AKK ka arritur të realizoj një pjesë të grantëve të parapara, përkatësisht në këtë periudhë AKK ka nënshkruar kontratë me GIZ, në shumë prej € 5,000. Me DEMOS, në shumë prej € 6,000, me MAPL në shumë prej, €6,000 dhe me NALAS, në shumë prej € 11,000. Poashtu gjatë kësaj periudhe, AKK ka nënshkruar një projekt me Save the Children në shumë prej 10,820 €.

AKK ka nënshkruar edhe një Memorandum Bashkëpunimi me UNICEF. Qëllim i këtij Memorandumi është mbështetja e lobimit të AKK-së në mbrojtjen e fëmijëve për vitin 2016-2017. Buxheti i paraparë për vitin 2016 është: \$20,000 (€18,000 afërisht).

Totali i granteve nga kontratat e nënshkrua për periudhën referuese është €56,820, ose 74 % e totalit të granteve të parapara për vitin 2016.

7. BASHKËPUNIMI ME PARTNERËT

Konteksti i angazhimeve të një mori organizatave në pushtetin lokal në Kosovë, - determinon dhe inkurajon Asociacionin e Komunave të Kosovës për një partneritet me këto organizata me të cilat i bashkërendon aktivitetet ngase ndërlidhen punët e përbashkëta me ta. Bashkëpunimi me partnerë AKK-së i ka ndihmuar në lobim e avokim, në realizimin e shumë projekteve që kanë përfituar komunat qoftë në fonde, përkrahje financiare në projekte, ofrim të shërbimeve, trajnime punëtori, shkëmbim të përvojave etj. Poashtu ky partneritet ka ndikuar edhe në ngritjen e performancës së komunave, ngritjen e kapaciteteve, lehtësimin e ofrimit të shërbimeve të ndryshme, plotësimin e mungesave të dokumenteve të nevojshme, bashkëpunimin mes komunave dhe bashkëpunimin mes komunave dhe organizatave të ndryshme etj.

SDC - Si partneri kryesor në zhvillimin dhe avancimin e AKK-së jep kontribut thelbësor si mbështetje institucionale për AKK-në. Programi i financuar nga SDC-ja i jep më shumë hapësirë veprimi, mbulimit të aktiviteteve të AKK-së varësisht nga koha dhe nevoja për lobim për dallim nga projekte e organizatave tjera. Programi mbështetës i financave nga SDC është gjithëpërfshirës në aktivitetet e AKK-së dhe i integruar me buxhetin bazë.

Miqtë e AKK-së / takimi vjetor - më partnerët kryesor të komunave të Kosovës të cilët merren dhe punojnë në fushën e qeverisjes lokale. Miqtë e AKK-së po funksionon si një mekanizëm shumë i rëndësishëm në bashkërendimin e aktiviteteve mes institucioneve lokale

dhe organizatave partnere të tyre. Vlen të theksohet roli kryesor që luan AKK-ja në këtë koordinim të takimit dhe aktiviteteve të tyre.

Partneriteti i AKK-së me projekte të ndryshme ndërlidhet në këto aktivitete kryesore:

- Bashkëpunimi me Projektin SDC/DEMOS për hartimin e “model rregullores për subvencione”. Këtij hartimi u paraprinë tre punëtore ditore, 6 takime me kolegjiunet profesionale (Kolegjiunimi i Kryesuesve të Kuvendeve të Komunës, Kolegjiunimi i Arsimit, Kolegjiunimi i Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale, Kolegjiunimi i Zhvillimit Ekonomik, Kolegjiunimi i Zyrtarëve Ligjor, Kolegjiunimi i Buxhetit dhe Financave) për t’a shqyrtuar projekt-rregulloren dhe për ta plotësuar në mënyrë që dokumenti final të ishte sa më i kompletuar dhe komunave të ju mbetet shumë pak punë në grupet punues para se ta miratojnë në Kuvendin e Komunës.
- AKK ishte partnere së bashku me DEMOS-in e Agjencisë për Barazi Gjinore- për organizimin e punëtorisë 3 ditore në Durrës ku u hartua “model rregullorja për përshkrimin e vendeve të punës së zyrtar-it/es për barazi gjinore ne ministri dhe komuna”.
- AKK mbështetur nga projekti DEMOS në bashkëpunim me MAPL-në ka kontribuar në hartimin e Udhëzuesit për bashkëpunim ndërkomunal. Në punëtorinë dy ditore të organizuar në Shkup kanë marrë pjesë Kryesuesit e Kolegjiuneve.
- AKK në bashkëpunim me Projektin e financuar nga BE “Mbështetje për Ministrinë e Punës dhe Mirëqenies Sociale në forcimin e mekanizmave për implementimin e decentralizimit të shërbimeve sociale” ka organizuar trajnime me zyrtarët komunal rreth zhvillimit të planifikimit dhe financimit të shërbimeve sociale, kapaciteti i përmirësuar për zhvilluar partneritetin publiko-privat; aftësia më e madhe për të ndërtuar partneritetet lokale në kujdesin dhe përkrahjen sociale, kapaciteti i ngritur për të negociuar dhe për të menaxhuar kontratat me akterët jo-shtetëror.
- Në Kolegjiunimin për Arsim është prezantuar përmes bashkëpunimit me GIZ, Arsimimi Bazik në Kosovë - ‘Planifikim i Integruar në Arsim’. Rezultatet dhe metodat e planifikimit të integruar në arsim të zbatuara në disa komuna nga projekti i GIZ-it janë ndarë me të gjitha komunat e tjera të Kosovës.
- Në bashkëpunim me projektin DEMOS janë organizuar disa punëtori me te gjitha komunat rreth aspektit të menaxhimit të hapësirave publik të komunave dhe të mobilitetit, si rezultat i punës së projektit DEMOS me komunat e tyre partner, ku praktikat më të mira është bërë e mundur të shkëmbehen edhe me komunat e tjera anëtare të AKK-së.
- Për të shënuar 15 vjetorin e themelimit të AKK-së janë organizuar aktivitete “JAVA E KOMUNAVE” e cila është realizuar më përkrahjen e MAPL-së, GIZ dhe DEMOS-it. Në këto aktivitete katërditore është mbajtur Konferenca për qeverisjen lokale, Panairi i Komunave, Tryeza për të ardhmen e Komunave dhe një Turniri në futboll të vogël ku kanë marrë pjesë 24 komuna.
- AKK në bashkë-organizim me projektin e KE - “Developing Together”, organizuan Konferencën për banim social në Kosovë, ku kjo konferencë mbledhi rreth 200 pjesëmarrës, zyrtar nga niveli qendror, nga niveli lokal, organizata të ndryshme dhe partner apo donatorët që kontribuojnë në Kosovë rreth banimit social. Ende mbetet sfida për komunat tona, rregullimi i çështjes së banimit social për qytetarët e tyre.

- AKK në bashkëpunim me projektin DEMOS në muajin dhjetor kanë organizuar punëtoritë një ditore me 24 komunat, për promovimin e ligjit për bashkëpunim ndërkomunal. Komunat janë bërë bashkë ajo që lidhen me territor, për të parë mundësinë se në cilat fusha apo cilat do të ishin projektet konkrete që do të realizoheshin për mes bashkëpunimit ndërkomunal.
- Pas inicimit dhe kërkesës së organizatës Save the Children për bashkëpunim me AKK, në shtator 2016 është formalizuar projekti i përbashkët katër mujor në mes të AKK-së dhe Save the Children, 'Përfshirja e fëmijëve në planifikim dhe buxhetim komunal'. Projekti ka për qëllim inicimin e dialogut ne mes te zyrtareve përgjegjës dhe komuniteteve (përfshirë edhe fëmijët) ne lidhje me çështjet e alokimeve buxhetore dhe kualiteteve te shërbimeve ne gjithë përfshirje ne arsim dhe zhvillim dhe kujdes ne fëmijëri te hershme ne Peje dhe Prishtine. Kjo do të arrihet përmes ngritjes së kapaciteteve të zyrtarëve komunal (arsimit, mirëqenies sociale dhe shëndetësisë, kulturës, zyrtaret e financave, koordinatorët për të drejtat e njeriut/barazi gjinore/fëmijë) ne komunat e Kosovës (me fokus te veçante ne Peje dhe Prishtine). Projekti në përfundim do të rezultojë me trajnim të përgjithshëm të zyrtarëve komunal dhe të asambleve të fëmijëve në këto dy komuna, për çështjen e lart cekur, si dhe do të hartojë një udhëzues rreth përfshirjes së fëmijëve në buxhetin në komuna i cili mund të përdoret nga edhe nga komunat e tjera.

8. AKTIVITETE DHE SHËRBIME TJERA

8.1 Komunikimi

Asociacioni i Komunave të Kosovës vazhdoi edhe këtë vit të mbaj kontakt dhe komunikim të vazhdueshëm me komunitet. Në këtë periudhë tek komunitet janë dërguar mbi 85 shkresa të ndryshme, njoftime, raporte, kthim përgjigje, projekt-ligje, projekt-rregulloret, rekomandime, propozim qëndrime, etj.

Duke zhvilluar transparencën, në uebfaqen e AKK-së janë vendosur vazhdimisht gjitha publikimet dhe broshurat e përgatitura nga AKK-ja dhe disa nga partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë dhe zyrtari për TI mirëmban në baza ditore uebfaqen. Këtë vit është dizajnuar edhe zhvilluar edhe uebfaqja e re e AKK-së me pamje dhe përmbajtje të re.

Po ashtu me nxjerrjen e publikimit periodik, të vetmin për pushtetin lokal, AKK-ja përgatit, shtyp dhe shpërndan Buletin në baza dymujore, e cila publikohet në tri gjuhë (Shqip, Serbisht dhe Anglisht). Në këtë periudhë raportimi janë përgatitur dhe publikuar gjashtë Buletine. Poashtu AKK-ja ka punuar në forcimin e imazhit të vetë qoftë edhe përmes produkteve identifikuese. Në këtë drejtim është edhe faqja sociale e AKK-së në 'Facebook' ku aty postohen gjitha lajmet dhe aktivitetet e saja. AKK-ja ka pasur një rol të madh në këtë drejtim, veçanërisht gjatë takimeve të mbajtura në ngjarjen “Java e Komunave” në muajin qershor.

8.2. Funksionimi i strukturave të AKK-së

Me angazhimin e vetë, Asociacioni i Komunave të Kosovës edhe në këtë vit ka kryer obligimet statutare të funksionalitetit të strukturave të veta. Janë organizuar disa takime të Këshillit të Kryetarëve, të cilin organ kemi filluar të fuqizojmë edhe më tutje si dhe është mbajtur takimi i Kuvendit të Përgjithshëm, i cili veç shqyrtimit të raporteve vjetore ka bërë edhe miratimin e Strategjisë së re 2016/2020.

8.3 AKK-ja si mekanizëm që ndihmon edhe nivelin qendror

Duke qenë se jemi shumë të pranishëm në zhvillimet nga niveli qendror, AKK-ja është parë dhe vlerësuar si një mekanizëm që jo vetëm që përfaqëson autoritetet lokale por mund të ndihmojë në çështje të caktuara edhe nivelin qendror. Në këtë gjashtëmujor kishim disa kërkesa nga Ministri e institucione të ndryshme të nivelit qendror për t'i ndihmuar në organizimin e takimeve të tyre me komunitet.

9. RAPORTI I AUDITIMIT



RSM KOSOVO SH.P.K

Str. Perandori Justinian 62
Qyteza Pejton
10 000 Prishtina
Republic of Kosovo

T +381 38 609 900
F +381 38 609 901
DL +377 45 666 888

www.rsmks.com

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Për Bordin e Asociacionit të Komunave të Kosovës

Opinion

Ne kemi audituar Raportin Financiar shoqërues të Asociacionit të Komunave të Kosovës ("OJQ"), të cilat përfshijnë pasqyrën e burimeve dhe përdorimit të fondeve për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, dhe shënime të raportit financiar, duke përfshirë një përmbledhje të politikave të rëndësishme të kontabilitetit.

Sipas opinionit tonë, raporti shoqërues financiar paraqet në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale pranimet dhe shpenzimet e paguara nga Asociacioni i Komunave Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2016, në përputhje me bazën e kontabilitetit siç përshkruhet në shënimin 2 të raportit financiar.

Bazat mbi Opinion

Ne kemi kryer auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA). Përgjegjësitë tona sipas këtyre standardeve janë të përshkruara më tej në seksionin e *Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Raportit Financiar*, të raportit tonë. Ne jemi të pavarur nga OJQ-ja për sa i përket pajtueshmërisë me *Kodin e Etikës për Kontablistët Profesionistë (Kodi IESBA)* të Bordit të Standardeve Ndërkombëtare të Etikës për Kontablistët dhe kemi përmbushur përgjegjësitë tona të tjera etike në përputhje me Kodin IESBA. Ne besojmë se evidenca e auditimit që ne kemi marrë është e mjaftueshme dhe e përshtatshme për të dhënë bazë mbi opinionin tonë.

Çështje të Tjera

Raporti financiar i Asociacionit të Komunave të Kosovës për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2015 është audituar nga një auditor tjetër i cili ka shprehur një opinion të pamodifikuar mbi ato raporte më 14 Mars 2016.

Përgjegjësitë e Menaxhmentit dhe Atyre të Ngarkuar me Qeverisje për Raportin Financiar

Menaxhmenti është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të raportit financiar në përputhje me bazën e kontabilitetit siç përshkruhet në shënimin 2 të raportit financiar dhe për kontrollin e brendshëm siç e përcakton menaxhmenti si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e raportit financiar që është i lirë nga anomalitë materiale të shkaktuara nga mashtrimi apo gabimi.

Në përgatitjen e raportit financiar, menaxhmenti është përgjegjës për vlerësimin e aftësisë së OJQ-së për vazhdueshmërinë, shpалosjen, nëse aplikohet, çështjet që lidhen në vazhdueshmërinë dhe duke përdorur këtë si bazë të kontabilitetit përveç nëse menaxhmenti synon të likuidojë OJQ-në, të pushojë operacionet, ose nuk ka asnjë alternative reale tjetër përveç kësaj.

Personat e ngarkuar me qeverisje janë përgjegjës për mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të OJQ-së.

Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Raportit Financiar

Objektivi jonë ka për bazë të marrim siguri të arsyeshme nëse raportet financiare si tërësi janë pa gabime materiale, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, dhe të përpilojmë një raport të auditorit që përfshin opinionin tonë. Siguria e arsyeshme nënkupton një nivel të lartë të sigurisë, por nuk është një garanci që një auditim i kryer në përputhje me ISA gjithmonë do të zbulojë një anomalë materiale, kur ajo ekziston. Anomalitë mund të lindin nga mashtrimi apo gabimi dhe konsiderohen si materiale nëse, individualisht ose të grupuara, ato mund të kenë ndikim në vendimet ekonomike që merren nga përdoruesit në bazën të këtyre raporteve financiare.

Si pjesë e auditimit në përputhje me SNA-të, ne ushtrojmë gjykimin profesional dhe ruajmë skepticizmin profesional gjatë gjithë auditimit. Ne gjithashtu:

- Identifikojmë dhe vlerësojmë risqet e anomalive materiale të raportit financiar, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit, hartojmë dhe zbatojmë procedura të auditimit të cilat u përgjigjen këtyre rreziqeve, dhe marrim dëshmi të auditimit që është e mjaftueshme dhe e përshtatshme, për të dhënë një bazë mbi opinionin tonë. Rreziku i mos zbulimit të një anomalie materiale që rezulton nga mashtrimi është më e lartë se sa nga ajo që rrjedh nga gabimi, pasi që mashtrimi mund të përfshijë marrëveshjen e fshehtë, falsifikim, lëshime të qëllimshme, keqinterpretime, apo shkelje të kontrollit të brendshëm.
- Sigurojmë një njohje të kontrollit të brendshëm që ka të bëjë me auditimin me qëllim që të përcaktojmë procedurat e auditimit që janë të përshtatshme sipas rrethanave, por jo për qëllime të shprehjes së një opinioni mbi efikasitetin e kontrollit të brendshëm të OJQ-së.
- Vlerësojmë përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arësyeshmërinë e çmuarjeve kontabël dhe të shpjegimeve përkatëse të bëra nga menaxhmenti.
- Nxjerrim një konkluzion në lidhje me përshtatshmërinë e përdorimit të bazës kontabël të vijmësisë, dhe bazuar në evidencën e auditimit të marrë, nëse ka një pasiguri materiale në lidhje me ngjarjet ose kushtet, e cila mund të hedhë dyshime të mëdha për aftësinë e OJQ-së për të vijuar veprimtarinë. Nëse ne arrijmë në përfundimin që ka një pasiguri ne duhet të tërheqim vëmendjen në raportin e auditorit në lidhje me shpjegimet e dhëna në raportin financiar, ose nëse këto shpjegime janë të papërshtatshme, duhet të modifikojmë opinionin tonë. Konkluzionet tona bazohen në evidencën e auditimit të marrë deri në datën e raportit tonë të auditimit. Megjithatë, ngjarje ose kushte të ardhshme mund të bëjnë që OJQ-ja të të ndërpresë veprimtarinë.
- Vlerësojmë paraqitjen e përgjithshme, strukturën dhe përmbajtjen e raportit financiar, përfshirë informacionet shpjeguese të dhëna, dhe nëse raporti financiar paraqet transaksionet dhe ngjarjet në to në një mënyrë që arrin paraqitjen e drejtë.

Ne komunikojmë me personat e ngarkuar me qeverisjen, përveç të tjerave, lidhur me qëllimin dhe kohën e auditimit dhe gjetjet e rëndësishme të auditimit, përfshirë ndonjë mangësi të rëndësishme në kontrollin e brendshëm që ne mund të identifikojmë gjatë auditimit.

RSM Kosovo Sh.p.k

Prishtinë, Kosovë
28 Mars 2017

RSM Kosovo Sh.p.k.



PASQYRA E BURIMEVE DHE PËRDORIMIT TË FONDEVE

		Për vitin e përfunduar 31 Dhjetor	
	Shënimet	2016 (në EUR)	2015 (në EUR)
BURIMET E FONDEVE			
Fondet e donatorëve	3	228,791	318,394
Të hyrat nga Pjesëmarrja e komunave	4	180,449	117,712
Të hyrat të tjera		1,965	634
TOTALI I FONDEVE NE DISPOZICION		411,205	436,740
PËRDORIMI I FONDEVE			
Shpenzimet e pagave	5	142,680	160,301
Lobimi / Avokimi	6	104,219	121,037
Shërbimet e zyrës	7	26,659	26,888
Komunikimet dhe publikimet	8	25,061	30,514
Zhvillimi i kapaciteteve	9	23,343	43,983
Pajisje dhe furnizime të zyrës	10	14,735	12,525
Shpenzimet e udhëtimit	11	12,785	8,362
Shpenzime të tjera	12	11,919	15,934
Totali i Shpenzimeve		361,401	419,544
Suficiti / (Deficiti) i fondeve të marra mbi shpenzimet		49,804	17,196
Fondet e kthyera tek donatorët		(41)	(2,583)
Suficiti i fondeve		49,763	14,613
Gjendja fillestare e parasë së gatshme dhe ne bankë		142,602	127,989
Gjendja e parasë së gatshme dhe në bankë në fund të periudhës	13	192,365	142,602